



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.34.dt.31.03.2000

MIRATIMI I DETAJIMIT TE FONDIT PER INVESTIME

Këshilli Bashkiak Tiranë, i mbledhur sot më dt.31.03.2000 pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Shërbimeve të Brëndëshme “Për detajimin e fondit prej 1.5 milion lekë sipas vendimit Nr.13 dt.03.03.2000, për blerje fotokopje, ventilimi i arshivës dhe investime të emergjencës”, mbështetur në ligjin Nr.7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, ligjit 7572 dt.10.06.1992 “Për organizimin e funksionimin e pushtetit lokal në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre

V E N D O S I

1. Të miratoi detajimin e fondit të investimeve nga të ardhurat prej 1.5 milion lekë për destinacionet e mëposhtme:
 - a) Rikonstrukcion rrjeti elektrik të zyrave të ish urbanistikës 1.000.000 lekë
 - b) Vendisje perde vertikale për zyrat tek ish urbanistika 250.000 “
 - c) Rrethimi i oborrit (pjesa e prapme) dhe dera në hyrje të Bashkisë 130.000 lekë
 - d) Investime të paparashikuara dhe emergjente 120.000 lekë
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI
ORHAN SAKIQI

